



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MARIANA DAKA  
ADRESA NJESIA BASHKIAKE NR. 5,  
RR. EMIN DURAKU, AP. 3/1, KATI  
PERDHE  
TEL: 0692058147

# KONTRATË SHITJE PASURIE E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 2036

Nr. koleksioni: 885

Tirane më 02/12/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

\* Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2020053860081745150



**KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI**  
( TË SHOQËRISË “IBERIC DRESS STYLE” SH.P.K)

Sot, më datë 02 Dhjetor 2020, para meje Notere MARIANA DAKA, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA BASHKIAKE NR. 5, RR. EMIN DURAKU, AP. 3/1, KATI PERDHE, u paraqiten personalisht:

“MC INVESTMENT GROUP” SH.P.K. person juridik shqiptar, i regjistruar më datën 09.07.2014, pranë QKB, me NIPT L41909013F, me seli në adresën: Njësia Bashkiake nr.5, Rruga “Ibrahim Rugova”, pallati 8, Hyrja 1, Tiranë përfaqësuar nga **Zj. Iva Veshi**, atësia Kujtim dhe amësia Merita, e datëlindjes 06.01.1987, lindur në Tiranë, shtetase shqiptare, banuese në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e Letërnjoftimit me numër 034312965 dhe me numër personal I75106061Q, autoritet lëshues MB, e autorizuar nëpërmjet Prokurës së Posaçme me Nr.Rep.992 dhe me Nr.Kol.446, datë 17.07.2020, të noterës Mariana Daka), i quajtur më poshtë si “**Shitësi**”.

**Shoqëria “Albeton 5” Shpk**, e rregjistruar në Rregjistrin Tregtar sipas Vendimit Nr. 6754 datë 15.09.1993 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NIPT J61817008G, me seli në Rr. “Perlat Rexhepi”, Godina 2-13 kate, Kati 2, Tiranë, përfaqësuar nga **Z.Adrian Dulaku**, atësia Niko dhe amësia Lirika, i datëlindjes 05 Shkurt 1960, lindur në Tiranë, shtetas shqiptar, banues në adresën: bulevardi “Bajram Curri”, godina ETC, kati i 17-të, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me numër 035240347 dhe numër personal G00205223S, me datë lëshimi 04.12.2019, autoritet lëshues MB i autorizuar sipas Vendimit të Asamblesë së Ortakëve të saj (bashkëlidhur si Aneksi 1); të quajtur më poshtë si “**Blerësi**” dhe

Të gjithë së bashku të quajtur më poshtë si “**Palët**”.

Pasi verifikova statusin juridik të palëve të sipërpërmendura, bazuar në Nenin 84, 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, unë noterja publike, vërtetoj se palët e sipërpërmendura janë me aftësi juridike për të vepruar me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, të cilët më kërkuan dhe ranë dakort në hartimin e kësaj Kontrate Shitje, bazuar në legjislacionin Shqiptar, sipas termave dhe kushteve të mëposhtme.

**TË DHËNA PARAPRAKE**

- 1.1. Shoqëria “MC Investment Group” sh.p.k. është pronare e 37.5% të kuotave të kapitalit të Shoqërisë “Iberic Dress Style” Shpk, kuota të cilat janë të lira nga çdo pretendim apo barrë në favor të të tretëve.
- 1.2. Shoqëria “Albeton 5” Shpk është pronare e 62.5% të kuotave të kapitalit të Shoqërisë “Iberic Dress Style” Shpk, kuota të cilat janë të lira nga çdo pretendim apo barrë në favor të të tretëve.

NENI 1

**Objekti**

- a. Objekti i kësaj Kontrate Shitje është kalimi i pronësisë, kundrejt shpërblimit, i 37.5% të kuotave të kapitalit të Shoqërisë “Iberic Dress Style” Shpk, të zotëruara nga ortaku “MC Investment Group” Shpk. në favor të Blerësit Shoqërisë “Albeton 5” Shpk.



## NENI 2

**Çmimi dhe Pagesa e tij**

Çmimi total për shitblerjen e kuotave të kapitalit, do të jetë në vlerën totale të tij prej **Lekë 37.500 (Tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind Lekë)**, duke u likujduar nga pala blerëse nëpërmjet transfertës bankare në numrin e llogarisë së shitësit, brenda 7 ditësh nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate. **Mandati bankar, në momentin që do të kryhet, bashkëlidhur kësaj kontrate do të vërtetojë likuidimin e çmimit të shitjes.**

Me nënshkrimin dhe legalizimin prej Noteres të kësaj Kontrate, Blerësit fitojnë pronësinë e plotë mbi këto kuota dhe kanë të drejtën të depozitojnë këtë Kontratë pranë QKB-së për pasqyrimin e kalimit në pronësi të tyre të kuotave të kapitalit të Shoqërisë.

Pas nënshkrimit të kësaj Kontrate Shitblerje të Kuotave, të dyja palët, në lidhje me këtë shit-blerje, nuk do të kenë më asnjë pretendim të tashëm a të ardhshëm kundrejt njëra – tjetrës.

Pas regjistrimit të kësaj Kontrate në QKB, Shoqëria “Albeton 5” Sh.p.k. do të zotërojë 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë “Iberic Dress Style” Sh.p.k. , duke e bërë shoqërinë “Albeton 5” Sh.p.k. ortake të vetme të shoqërisë “Iberic Dress Style” Sh.p.k.

## NENI 3

**Taksat dhe Kontributet**

Çdo taksë apo tarifë e cila lidhet me kalimin e pronësisë së kuotave apo gjithçka tjetër që lind si rrjedhojë e përmbushjes së termave të kësaj Kontrate do të kryhet sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

## NENI 4

**Njoftimet**

- a. Të gjitha njoftimet dhe komunikimet e kërkuara apo që mund të lindin nga kjo Kontratë do të kryhen me shkrim dhe do të konsiderohen të marra, nëse dorëzohen personalisht apo me email (me verifikim marrjeje), të dërguara me postë (rekomande) Palëve në adresat e mëposhtme, ose adresa të tjera të përcaktuara me shkrim në vazhdimësi:

**SHITËSI:**

**Shoqëria “MC Investment Group” Shpk**

† **Adresa:** Njësia Bashkiake nr.5, Rruga “Ibrahim Rugova”, pallati 8, Hyrja 1, Tiranë

**BLERËSI:**

**Shoqëria “Albeton 5” Shpk**

† **Adresa:** Rr. “Perlat Rexhepi”, Godina 2-13 kate, Kati 2, Tiranë

† **Email:** [info@edilal.com](mailto:info@edilal.com)

- b. Çdo ndryshim në adresat e specifikuar më sipër duhet të njoftohet në kohë dhe me shkrim palës tjetër, duke përdorur të njëjtat metoda siç janë përcaktuar në këtë nen.

## NENI 5

**Shpenzimet**

Të gjitha shpenzimet në lidhje me këtë Kontratë, përfshirë kostot e Noterit Publik, do të paguhen nga Palët në mënyrë të barabartë.

## NENI 6

**Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

- a. Kjo Kontratë do të interpretohet sipas Ligjit Shqiptar. Çfarëdo çështje e cila nuk parashikohet nga kjo Kontratë, do të zgjidhet sipas dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit “Për



Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

- b. Në rast të ndonjë mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve dhe që ka të bëjë me interpretimin, zbatimin, përfundimin e kësaj Kontrate, Palët bien dakort të bëjnë maksimumin e mundshëm për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje në mënyrë miqësore.
- c. Nëse pas përpjekjeve të arsyeshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në rrugë miqësore, zgjidhja nuk arrihet për 30 (tridhjetë) ditë nga tentativa e parë për zgjidhje miqësore, atëherë mosmarrëveshja do të zgjidhet në rrugë gjyqësore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

#### NENI 7

##### Konfidencialiteti

Palët janë të detyruara të ruajnë konfidencialitetin e të gjithë informacionit të përfshirë në këtë kontratë dhe të mos e kalojnë atë në asnjë formë tek të tretët.

#### NENI 8

##### Anekset e Kontratës

- a. Sikundër është përcaktuar edhe më lart në këtë Kontratë, Palët kanë detajuar në Anekse të posaçme të dhëna të nevojshme dhe të domosdoshme për qartësimin e Kontratës dhe të vetë marrëdhënies ndërmjet Palëve.
- b. Në të tilla kushte, këto Anekse do të jenë pjesë përbërëse dhe e pandashme e Kontratës, duke pasur të njëjtën fuqi ligjore për Palët ashtu si edhe vetë kjo Kontratë.
- c. Anekset e Kontratës janë:

**Aneksi 1:** Vendim i Ortakut të Vetem të Shoqërisë "Iberic Dress Style" shpk  
Vendimi i Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "Albeton 5" Shpk  
Vendimi i Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "MC Investment Group" Shpk

**Aneksi 2:** Ekstrakt nga QKB i Shoqërisë "Iberic Dress Style" Shpk.

**Aneksi 3:** Ekstrakt nga QKB i Shoqërisë "Albeton 5" Shpk dhe "MC Investment Group" shpk

#### NENI 8 - Të ndryshme

Kjo kontratë është përgatitur në 4 (katër) kopje të njëjta në gjuhën Shqipe, nga një kopje prej të cilave i vendoset në dispozicion Shitësit dhe Blerësit, respektivisht, një kopje depozitohet në regjistrat e QKB-së, një kopje në arkivën e Shoqërisë dhe një kopje mbahet në Zyrën e Noterisë Tiranë.

Kontrata hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të Kontratës nga Palët pjesmarrëse.

Palët në këtë kontratë deklarojnë se janë njohur me përmbajtjen e saj dhe shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë në firmosjen e saj.

#### PALËT

##### SHITËSI

Shoqëria "MC Investment Group" Shpk

Përfaqësuar nga:

Zj.Iva Veshi

*Iva Veshi*

##### BLERËSI

Shoqëria "Albeton 5" Shpk

Përfaqësuar nga:

Z.Adrian Dulaku

*Adrian Dulaku*

##### Noter

MARIANA DAKA

*Mariana Daka*





## VENDIM

### I ASAMBLESË SE SHOQERISE

### “IBERIC DRESS STYLE” SHPK

Sot, më datën 27 Nëntor 2020, në adresën: Bulevardi "Bajram Curri", godina ETC, kati i dyte, Njesia Bashkiake Nr.2, Tirane Shqiperi, zhvillohet mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë "IBERIC DRESS STYLE" Shpk e thirrur rregullisht nga Administratori i Shoqërisë Z. Eraldi Bego.

Shoqëria "IBERIC DRESS STYLE" Sh.p.k. është regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, me NIPT L71312016G, me ortakë të shoqërisë, Shoqërinë "Albeton 5" Sh.p.k., që zotëron 62.5% të pjesëve në kapitalin e shoqërisë dhe Shoqërinë "MC INVESTMENT GROUP" që zotëron 37.5% të pjesëve në kapitalin e shoqërisë.

Në këtë mbledhje të jashtëzakonshme të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë "IBERIC DRESS STYLE" Shpk, të thirrur me kërkesën e Administratorit të Shoqërisë Z.Eraldi Bego, u verifikua dhe u konstatua prania e Ortakëve të Shoqërisë :

- **Shoqëria "Albeton 5" Sh.p.k** e cila zotërohet nga Ortaku i Vetëm Shoqëria "Concord Investment" Shpk, e cila në këtë mbledhje të Asamblesë së Shoqërisë "IBERIC DRESS STYLE"sh.p.k. përfaqësohet nga Ortakët e saj : Z.Artan Dulaku, që zotëron 34% (tridhjetë e katër përqind) të pjesëve në kapitalin e shoqërisë, Z.Adrian Dulaku, që zotëron 33% (tridhjetë e tre përqind) të pjesëve në kapitalin e shoqërisë dhe Z. Genci Dulaku, që zotëron 33% (tridhjetë e tre përqind) të pjesëve në kapitalin e shoqërisë.
- **Shoqëria "MC INVESTMENT GROUP" Sh.p.k.** person juridik shqiptar, i regjistruar më datën 09.07.2014, pranë QKB, me NIPT L41909013F përfaqësuar nga **Zj. Iva Veshi**, atësia Kujtim dhe amësia Merita, e datëlindjes 06.01.1987, lindur në Tiranë, shtetase shqiptare, banuese në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e Letërnjoftimit me numër 034312965 dhe me numër personal I75106061Q, autoritet lëshues MB, sipas Prokurës së Posaçme me Nr.Rep.992 dhe me Nr.Kol.446, datë 17.07.2020, të noteres Mariana Daka.

Pasi Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë "IBERIC DRESS STYLE" Shpk, shqyrtoi dokumentacionin dhe aktet përkatëse, në përputhje me Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", me votën pro, të shumicës së kuotave të kapitalit të shoqërisë, pra me shumicën e kërkuar nga ligji, në përfundim, në unanimitet të plotë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë shit-blejen e kuotave që shoqëria "MC INVESTMENT GROUP" Sh.p.k. zotëron në shoqëri, brenda shoqërisë, tek ortakët tjetër shoqëria "Albeton 5" sh.p.k. kundrejt çmimit total prej 37'500 Lekë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Per shoqerine:  
"IBERIC DRESS STYLE" shpk  
ORTAKËT :

Albeton 5 shpk  
Perfaqesuar nga:  
Ortaku i Vetëm  
"Concord Investment" Sh.p.k.



Z. Artan Dulaku

Z. Adrian Dulaku

Z. Genci Dulaku

"MC INVESTMENT GROUP" SH.P.K

Perfaqesuar nga Zj. Iva Veshi

Iva Veshi



**V E N D I M**  
**I ORTAKUT TË VETËM TË**  
**SHOQËRISË "ALBETON 5" SHPK**

Sot, më datë 27 Nëntor 2020, në selinë e Shoqërisë "ALBETON 5" Shpk, të ndodhur në adresën: Rr. "Perlat Rexhepi", Godina 2-13 kate, Kati 2, Tiranë, zhvillohet mbledhja e Ortakut të Vetëm të kësaj Shoqërie, konkretisht Shoqëria "Concord Investment" Shpk.

**Shoqëria "Albeton 5" Shpk**, e rregjistruar në Rregjistrin Tregtar sipas Vendimit Nr. 6754 datë 15.09.1993 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NIPT J61817008G, gjatë veprimtarisë së saj drejtohet nga Administratori Z. Sotiraq Toshi.

Kjo mbledhje e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "Albeton 5" Shpk, e thirrur me kërkesën e Administratorit Sotiraq Toshi, shqyrton këto probleme sipas,

***Rendit të ditës:***

1. Miratimin e blerjes së 37.5% të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "IBERIC DRESS STYLE" Sh.P.K të zotëruara nga Shoqëria "MC Investment" Group Shpk, tek blerësi Shoqëria "Albeton 5" Sh.p.k kundrejt vlerës totale prej 37.500 Lekë.
2. Autorizimin e z. Adrian Dulaku, të nënshkruajë aktet përkatëse, si Kontratë Shitje të Kuotave dhe çdo akt tjetër që ka si rend dite:
  - a. *Kalimin e 37.5% të kuotave të kapitalit të zotëruara nga Shoqëria "MC Investment" Group Shpk në Shoqërinë "IBERIC DRESS STYLE" Sh.P.K., tek blerësi, ortaku tjetër **Shoqëria "Albeton 5" Sh.p.k**, kundrejt vlerës totale prej 37.500 Lekë.*
  - b. *Pas blerjes së kuotave të kapitalit, ortak i vetëm i Shoqërisë "IBERIC DRESS STYLE" Sh.P.K., do të jetë blerësi **Shoqëria "Albeton 5" Shpk**, e cila do të zotërojë 100% të pjesëve të kapitalit të shoqërisë.*

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë "Albeton 5" Shpk, pasi shqyrtoi dokumentacionin përkatës, në përfundim, me vullnet të lirë dhe të plotë,

**V E N D O S I:**

Të miratojë,

3. Miratimin e blerjes së 37.5% të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "IBERIC DRESS STYLE" Sh.P.K të zotëruara nga Shoqëria "MC Investment" Group Shpk, tek blerësi Shoqëria "Albeton 5" Sh.p.k kundrejt vlerës totale prej 37.500 Lekë.
4. Autorizimin e z. Adrian Dulaku, të nënshkruajë aktet përkatëse, si Kontratë Shitje të Kuotave dhe çdo akt tjetër që ka si rend dite:
  - c. *Kalimin e 37.5% të kuotave të kapitalit të zotëruara nga Shoqëria "MC Investment" Group Shpk në Shoqërinë "IBERIC DRESS STYLE" Sh.P.K., tek blerësi, ortaku tjetër **Shoqëria "Albeton 5" Sh.p.k**, kundrejt vlerës totale prej 37.500 Lekë.*

d. Pas blerjes së kuotave të kapitalit, ortak i vetëm i Shoqërisë "TBERIC DRESS STYLE" Sh.P.K., do të jetë blerësi **Shoqëria "Albeton 5" Shpk**, e cila do të zotërojë 100% të pjesëve të kapitalit të shoqërisë.

Sa më sipër, ky vendim i Ortakut të Vetëm dhe këto dokumenta do të depozitohen pranë organeve përkatëse.

**SHOQËRIA "ALBETON 5" SHPK**

**ORTAKU I VETËM**


**Shoqëria "CONCORD INVESTMENT" Shpk**


**Përfaqësuar nga**

**Artan Dulaku**


**Adrian Dulaku**

**Genci Dulaku**













REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

## EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

### GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L71312016G
2. Data e Regjistrimit	12/01/2017
3. Emri i Subjektit	IBERIC DRESS STYLE
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	06/01/2017
6. Kohëzgjatja	Nga: 06/01/2017
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Njësia Bashkiake Nr. 2, Bulevardi Bajram Curri, Godina ETC, Pasuria me numër 2/276-N25, vol. 39, fq. 51, Zona Kadastrale 8160
8. Kapitali	100.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00
9. Objekti i aktivitetit	Aktivitet ne fushen e tregtimit, importimit dhe eksportimit, me shumice ose me pakice, te artikujve dhe mallrave te ndryshme si konfeksione, tekstile, te te gjitha llojeve; Aktivitet ne fushen e tregtimit, importimit dhe eksportimit, me shumice ose me pakice, te veshjeve sportive. Aktivitet ne fushen e magazinimit dhe te shperndarjes se artikujve dhe mallrave te ndryshme sipas objektit te aktivitetit te shoqerise. Veprimtari te marketingut, publiciteteve dhe te fushave promovuese, te artikujve dhe mallrave sipas objektit te aktivitetit te shoqerise, ne zhvillim te kerkesave te tregut. Kontraktim me persona fizike dhe juridike, vendas ose te huaj, per gjetjen e tregjeve te shitjes per artikujt dhe mallrat, per keshillimin dhe konsultimin per aktivitetet e percaktuara me lart si dhe cdo tregtim apo sherbim qe lidhet drejtepersedrejti ose terthorazi me ushrimin e aktivitetit te objektit te shoqerise. Si dhe te tjera aktivitete te pergjithshme biznesi.
10. Administratori/ët	Eraldi Bego



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

10.1 Afati i emërimit	Nga: 23/09/2020	Deri: 23/09/2021
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	MC Investment Group	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 37.500,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	37,50	
12.4 Komente (nëse ka)		
13. Ortakët	ALBETON 5	
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 62.500,00	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve	1,00	
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	62,50	
13.4 Komente (nëse ka)		
14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: IBERIC DRESS STYLE E-Mail: ibericdressstyle.office@gmail.com Telefon: 0692836120	
16. Statusi:	Aktiv	

Datë: 17/11/2020

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi  
(i nëpunësit të sportelit)



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**

**DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER MARIANA DAKA**  
**ADRESA NJESIA BASHKIAKE NR. 5,**  
**RR. EMIN DURAKU, AP. 3/1, KATI**  
**PERDHE**  
**TEL: 0692058147**

## **PROKURË E POSAÇME**

**Nr. repertori: 992**

**Nr. koleksioni: 446**

**Tirane më 17/07/2020**

**Ligjet referuese:**

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Per mbrojtjen e te dhenave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

\* Akti noterial përbëhet nga 1 fletë



A2020053860034235242



A2020053860034235242



## PROKURË E POSAÇME

Sot, më datë 17 Korrik 2020, para meje Notere MARIANA DAKA, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA BASHKIAKE NR. 5, RR. EMIN DURAKU, AP. 3/1, KATI PERDHE, u paraqit personalisht:

### (/E) PERFAQESUAR:

**Z. Eduard HYSANI**, i biri i Abdulla-it dhe i Qerime-s, I datëlindjes 05.07.1966, lindur dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar prej meje noteres me Letërnjoftimit me numer 032940972 dhe me numër personal G60705042K, në cilësinë e **Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "MC INVESTMENT GROUP" SH.P.K.** person juridik shqiptar, i regjistruar më datën 09.07.2014, pranë QKB, me NIPT L41909013F, me seli në adresën: Njësia Bashkiake nr.5, Rruga "Ibrahim Rugova", pallati 8, Hyrja 1, Tiranë, **SI DHE** në cilësinë e **Përfaqësuesit të Administratores së Shoqërisë "MC INVESTMENT GROUP" SH.P.K.** Zj.Enkeleda Duka, i autorizuar nëpërmjet Prokurës së Përgjithshme me Nr.Rep. 1045 dhe me Nr.Kol.449, datë 03.09.2014 të noteres Flora Kalaja, më deklaroi të dhënat e mësipërme dhe më kërkoi përpilimin e kësaj prokure të posaçme me përmbajtjen si më poshtë vijon:

Emëroj si Përfaqësuese të Posaçme, **Zj. Iva Veshi**, atësia Kujtim dhe amësia Merita, e datëlindjes 06.01.1987, lindur në Tiranë, shtetase shqiptare, banuese në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e Letërnjoftimit me numër 034312965 dhe me numër personal I75106061Q, autoritet lëshues MB ("Përfaqësuesi"), të cilës i jap të drejta dhe tagra të plota, që në emër dhe për interesin e shoqërisë që unë përfaqësoj, të më përfaqësojë dhe të nënshkruajë para noterit të gjitha Aktet e nevojshme Noteriale për konkludimin e Shitjes ose Dhurimit të Kuotave që Shoqëria "MC INVESTMENT GROUP" SH.P.K. zotëron tek Shoqëria "IBERIC DRESS STYLE" me NIPT L71312016G.

Përfaqësuesja e posaçme ka të drejtën që për kuotat që shoqëria që unë përfaqësoj zotëron tek Shoqëria "IBERIC DRESS STYLE" të nënshkruajë përpara Noterit Kontratë Shitje Kuotash, Kontratë Dhurimi Kuotash, Vendim Asambleje me rend dite shitjen ose Dhurimin e kuotave që shoqëria "MC INVESTMENT GROUP" SH.P.K. zotëron tek Shoqëria "IBERIC DRESS STYLE" si dhe çdo akt tjetër ligjor noterial ose jo noterial që i shërben qëllimit të kësaj Prokure.

Kjo prokurë e posaçme është e vlefshme vetëm për veprimet e përshkruara sa më sipër. Çdo veprim apo transakcion i ndryshëm nga qëllimi për të cilin lëshohet kjo prokurë, do të konsiderohet i pavlefshëm dhe nuk do të sjellë pasoja.

Për sa më sipër, përpilohet nga unë noterja kjo prokurë e posaçme, e cila ju lexua me zë të lartë nga unë noteria dhe u kuptua nga i përfaqësuari, dhe meqenëse gjendet konform vullnetit të tij të lirë dhe të plotë firmoset rregullisht, ndërsa unë noterja e vërtetoj nënshkrimin e tij dhe këtë prokurë sipas ligjës dhe në bazë të nenit 72, e vijues të Kodit Civil, të Republikës së Shqipërisë.

### I PËRFAQËSUARI

Shoqëria "MC INVESTMENT GROUP" SHPK

Përfaqësuar nga:  
Z. Eduard Hyseni

NOTER  
MARIANA DAKA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

## EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

### GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	J61817008G
2. Data e Regjistrimit	15/09/1993
3. Emri i Subjektit	ALBETON 5
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	14/09/1993
6. Kohëzgjatja	Nga: 14/09/1993
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga Perlat Rexhepi, Godina me 2-13 Kate, Kati i 2
8. Kapitali	80.302.244,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	100,00
9. Objekti i aktivitetit	Shfrytëzimi i kavave ne lumenj e ne male dhe perpunimi i igrerteve. Prodhimi i materialeve industriale te ndertimit si brenda dhe jashte territorit shqiptar. Pergatitja dhe shperndarja e ilaçit, çimentos dhe konglomerateve bituminoze, perpunimit te lendes se drurit, hekur-betonit e konstruksioneve metalike. Blerja apo marrja me qera e truallit per ndertimin e fabrikave, linjave dhe impianteve per prodhimin e materialeve te ndertimit. Dhenia me qera te treteve e makinerive dhe pajisjeve qe ajo disponon. Zhvillimi i sherbimeve ne Ndërtimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave civile, turistike, kulturore, tregtare e sportive, shtetërore apo private, e rrugëve, ujësjellësave, kanalizimeve, aeroportëve, porteve, digave, ne territorin shqiptar dhe jashtë saj. Blerja, shitja dhe marrja me qera e ndërtimeve.Pjesemarrja nepermjet aksioneve apo formave të tjera, ne menyre te drejteperdrejte ose jo ne shoqëri të tjera të cilat zhvillojnë aktivitete të ngjashme apo të njëjta me të. Vënia në dispozicion e teknologjisë së saj në sektorë të prodhimit dhe në atë të ndërtimit. Zhvillimi i aktiviteteve financiare të cilat kanë të bëjnë me objektivat e shoqërisë. Ushtrim aktiviteti në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	<p>fushën e njësisve akomoduese, shërbime hoteleri-turizëm, bar, restorant, si dhe shërbime të tjera të karakterit shoqëror dhe turizmit. Kryerja e shërbimeve turistike dhe organizimit të eventeve të ndryshme, për klientët dhe turistët vendas apo të huaj, individuale apo të organizuar; vënie në dispozicion të sallave, ambienteve për organizimin e aktiviteteve të ndryshme si seminare, trajnime, konferenca, takime biznesi, trajnime, veprimtarive lokale, festave familjare etj, të ambienteve të hotelit. Konsulencë në fushën e menaxhimit dhe planifikimit hotelier e turistik. Agjensi apo Operator turistik dhe shërbime të tjera të karakterit shoqëror dhe turizmit, shërbime marketingu, etj. Organizim i guidave turistike dhe shëtitjeve të organizuara për turistët vendas dhe të huaj. Import-eksport dhe tregtim të mallrave dhe artikujve të ndryshëm, ushqimore, veshje, suvenire, kozmetike, etj. Promocioni dhe çdo lloj veprimtarie tjetër të lidhur me sa më sipër dhe të lejuara nga ligji. Tregtia e mallrave të të gjitha llojeve ushqimore apo produkte-shtesa ushqimore, me shumicë dhe me pakicë. Veprimtari tregtare për produkte dhe shërbime të markave të ndryshme, mundësi të përdorimit dhe shërbimeve të tregut, për produkte-lëndë të para ushqimore apo produkte-shtesa ushqimore. Blerjen me qëllim furnizimin me mallra ushqimore të përgjithshme në bashkëpunim me shoqëri dhe ente kooperative, të tjera, si dhe import-eksportin e mallrave të ndryshme që janë objekt i veprimtarisë tregtare. Prodhimin në llogari të vetë me formë shoqate ose shoqërie të mallrave ushqimore dhe jo të estinuar për shitje pranë pikave të veta ose filialeve ose pikave të kontrolluara dhe/ose për eksport. Rritjen dhe transformimin e ushqimeve me origjinë ushqimore për tregun e brendshëm të Shqipërisë dhe atë të jashtëm.</p>
10. Administratori/ët 10.1 Afati i emërimit	Sotiraq Toshi Nga: 21/11/2012      Deri: 03/07/2020
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)	b)Administratori i shoqërisë ka të drejtë të nënshkruajë hua, kredi, discounts dhe çdo ofrim fondesh, që përmban një kredi ose debi për shoqërinë, vetëm në bazë të një vendimi miratues të Ortakut i Vetem.c)Administratori i Shoqërisë nënshkruan/autorizon çdo transaksion bankar deri në shumën prej Euro 15.000(pesembdhedhjeje mije ose kundërvlerën në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	<p>leke ose volute tjeter, per muaj kalendarik, ne cdo banke te nivelit te dyte se bashku me Drejtorin e Finances se Shoqerise. Ne rast te tejkalimit te shumes te percaktuar ne kete paragraf operacionet perkates do te miratahet nga Administratori dhe kunder firme te Ortakut te Vetem ose cdo personi qe mund te autorizohet posacerisht per nje transaksion specifik ose pergjithesisht per cdo transaksion qe perfshihet ne kete paragraf, sipas nje vendimi te Ortakut te Vetem.d) Administratori i Shoqerise do te nenshkruaje bashkerisht me Ortakun e Vetem cdo akt ligjor, kontrate, marreveshje, deklarate te cdo lloji qe do te kete lidhje me shitblerjen ose transferimin e te drejtave mbi asetet e prekshme dhe te paprekshme te shoqerise duke perfshire pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme. Kufizimet e misiperme nuk jane te aplikueshme per cdo transaksion qe ka per qellim pagesat e detyrueshme te lidhura me administrimin e zakonshem te aktivitetit te Shoqerise duke perfshire por pa u kufizuar ne pagesen e taksave, tarifave dhe kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore, pagat e punemarresve, detyrimet per furnitoret e energjise elektrike dhe ujit, gjobat dhe penalitetet qe lidhen me to, te cilat Administratori mund te autorizojë dhe kryejë i vetem.</p>	
12. Ortakët	CONCORD INVESTMENT	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 80.302.244,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	100,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
12.4 Komente (nëse ka)		
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Tirane Tirane TIRANE URA FARKES Tirane Tirane TIRANE FABRIKA QELQIT Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake Nr. 4, Rruga 5 Maj, Qendra Concord Center, Kati (-1), Dyqani 1	
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: ALBETON 5 E-Mail: migena.bejko@edilal.com Telefon: 042271885	
15. Statusi:	Aktiv	



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

Datë: 23/09/2020

\_\_\_\_\_  
Emri, Mbiemri, Nënshkrimi  
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga Web